

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal
2020-2030

(Periudha: Janar 2024-Dhjetor 2024)

Prishtinë 2025

Hyrje

Strategjia për Zhvillim Rajonal (2020-2030) është dokumenti themelor që përcakton kuadrin strategjik të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për arritjen e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm të rajoneve zhvillimore, me qëllim të tejkalimit të dallimeve/pabarazive brenda dhe ndër-rajonale në kontekst të zbatimit të politikës evropiane të kohezionit dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe gjithëpërfshirëse.

Strategjia për Zhvillimit Rajonal (2020-2030) përcakton qëllimet dhe prioritetet afatgjate 10-vjeçare të politikës së zhvillimit rajonal, që mundëson koordinimin e politikave sektoriale në territorin përkatës të rajonit zhvillimor dhe mbështetë sinkronizmin mes tyre. Strategjia ka një rol të rëndësishëm për arritjen e përputhshmërisë dhe sinergjisë ndërmjet qëllimeve dhe prioritetëve të politikës së zhvillimit rajonal dhe politikave dhe strategjive sektoriale, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e balancuar të rajoneve zhvillimore.

Strategjia për zhvillim rajonal, përcakton politikat prioritare të Qeverisë, në nivel afatmesëm dhe jep orientimet strategjike zhvillimore afatgjate.

Me qëllim të monitorimit të implementimit të strategjisë për Zhvillim Rajonal, Ministria e Zhvillimit Rajonal, në bazë periodike harton raporte monitoruese për implementim të aktiviteteve sektoriale, aktiviteteve të komunave, OJQ-ve dhe aktiviteteve të MZHR, për të pasqyruar nivelin e realizimit dhe përmbushjes së detyrimeve sektoriale që dalin nga kjo strategji.

Raporti i shërben Qeverisë për të parë nivelin e zbatimit të strategjisë si dhe për të ri-orientuar nëse është e nevojshme politikat zhvillimore, i shërben institucioneve të cilat kanë përgjegjësi konkrete në zbatimin e aktiviteteve të kësaj strategjie, organizatave jo qeveritare, organizatave ndërkombëtare dhe të gjitha palëve tjera të interesuara, për të parë progresin e arritur nga fusha e zhvillimit rajonal, si dhe për orientimet programore për periudhën e ardhshme sa i përket zhvillimit rajonal.

MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR MONITORIM

Me qëllim të vendosjes së një mekanizmi monitorues, Ministria e Zhvillimit Rajonal, në cilësinë e institucionit përgjegjës për të monitoruar implementimin e strategjisë së zhvillimit rajonal, përmes planit të veprimit, ka përcaktuar aktivitetet dhe detyra konkrete, me afate të caktuara dhe me indikatorët përkatës, me qëllim të implementimit të strategjisë për zhvillimin rajonal. Meqenëse strategjia për zhvillim rajonal, është strategji multi-sektoriale, janë përcaktuar institucionet përgjegjëse, të cilat mbështesin Minsitrinë e Zhvillimit Rajonal, në arritjen e objektivave të strategjisë, të vendosura nga Qeveria. Poashtu, me qëllim të pasqyrimin të aktiviteteve për arritjen e objektivave si dhe realizimin e planit të implementimit të Strategjisë për Zhvillim Rajonal, Ministria për Zhvillim Rajonal harton raporte në baza periodike për të evidentuar progresin dhe sfidat në procesin e implementimit të strategjisë.

MZHR në përputhje me detyrimet e saj që përcaktojnë mandatin e saj, në mbështetje të UN-HABITAT projektit për shërbime të qëndrueshme komunale) ka koordinuar procesin e krijimit të mekanizmit monitorues të implementimit të strategjisë, me ç'rast janë evidentuar përgjegjësitë sektoriale të secilit institucion përgjegjës, apo mbështetës në nivelin qendror, komunave dhe shoqërisë civile.

Prandaj, me qëllim të evidencës së progresit për realizimin e aktiviteteve që dalin nga strategjia ka hartuar raportin 1 vjeçar të implementimit të strategjisë, për vitin 2024. Qëllimi i këtij raporti është identifikimi i aktiviteteve dhe rezultateve të arritura nga kjo strategji si dhe evidentimin e sfidave dhe hapave konkret për adresimin e tyre, me qëllim të arritjes së synimeve të përcaktuara nga Qeveria, për avancimin e zhvillimit rajonal.

Me qëllim të vendosjes së një mekanizmi ndër-sektorial për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal, MZHR me vendim nr. 70 ka themeluar grupin ndër-sektorial, të cilët janë koordinatorët e procesit të implementimit të strategjisë për zhvillim rajonal, nën udhëheqjen e MZHR-së.

Në bazë të objektivave të caktuara dhe synimeve për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal 2020-2030, grupi ndër-sektorial për zbatimin e strategjisë është në përbërëje të institucioneve, si vijon:

- Ministria e Zhvillimit Rajonal;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Zyra e Kryeministrit
- Zyra për Planifikim Strategjik
- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Ministria për Komunitet dhe Kthim;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Veri"
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Jug"
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Qendër"
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Lindje"
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Perëndim"

Grupi Punues takohet në baza të rregullta dhe raporton në bazë periodike, sipas kërkesave të MZHR.

LISTA E SHKURTESAVE

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
ZKM	Zyra e Kryeministrit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPHI	Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ME	Ministria e Ekonomisë
MKK	Ministria për Komunitet dhe Kthim
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
AZHR	Agjension për Zhvillimor Rajonal

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Strategjia për Zhvillim Rajonal ka gjithsej tri objektiva:

Objektivi Strategjik: 1. Koordinimi i politikave për zhvillim rajonal;

Objektivi Strategjik: 2. Zhvillimi rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale;

Objektivi Strategjik: 3. Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane.

Në kuadër të **Objektivi Strategjik: 1. Koordinimi i politikave për zhvillim rajonal**, me qëllim të realizimit të aktiviteteve konkrete, janë parashikuar dy objektiva specifike, si vijon:

Objektivi Specifik: 1.1 Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Objektivi Specifik: 1.2 Themelimi i mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, për hartimin monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe performancës rajonale.

Në **Objektivi Strategjik: 2. Zhvillimi rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale**, janë parashikuar edhe 4 objektiva specifike, si vijon:

Objektivi Specifik: 2.1 Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në bazë të vlerësimeve;

Objektivi Specifik: 2.2 Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik;

Objektiv Specifik: 2.3 Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Objektivi Specifik: 2.4 Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonal përmes programeve trans nacionale.

Në **Objektivi Strategjik: 3. Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane.**, janë parashikuar edhe 3 objektiva specifike:

Objektivi Specifik: 3.1 Inventarizimi i resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane;

Objektivi Specifik: 3.2 Ndërtimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve;

Objektiv Specifik: 3.4 Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Ndërsa, me qëllim të evidentimit të objektivave të strategjisë, janë vendosur synimet si vijon (të pasqyruara në tabelën 1), të cilat do të monitorohen dhe do të vlerësohen nga aspekti implementimit përmes planit të veprimit dhe raporteve monitoruese:

Synimet e përcaktuara për vitin 2024, për realizimin e objektivave strategjike të strategjisë për zhvillim rajonal	Vlera bazë 2020	Synimi 2023	Synimi 2024
Kornizë ligjore e përafruar me legjislacionin e BE-së, në fushën e zhvillimit rajonal			
Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar	0%	60%	100%
Themelimi i mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, për hartimin monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe performancës rajonale.	20%	100%	100%
Zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale			
Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioritetëve në baze të vlerësimeve.	0%	15%	15%
Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar	0%	17%	17%
Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonal përmes programeve trans nacionale.	0%	30%	30%
Arritja e niveleve më të larta të produktivitetit ekonomik përmes diversifikimit, përmirësimit teknologjik dhe inovacionit.	0%	25%	25%
Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane;			
Inventarizimi i resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane.	0%	45%	45%
Ndërtimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve.	0%	15%	20%
Hartimi dhe zbatimi i politikave për promovimin e turizmit të qëndrueshëm që krijon vende pune dhe promovon kulturën, produktet lokale dhe rajonale.	0%	15%	20%
Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.	0%	10%	20%

OBJEKTIV STRATEGJIK: 1. KOORDINIMI I POLITIKAVE PËR ZHVILLIM RAJONAL;

Objektivi Specifik 1.1. – Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Veprimi -1.1.1 Hartimi dhe miratimi i kornizës ligjore për zhvillim rajonal të balancuar ;

("Institucioni Kryesor: MZHR: Institucione mbështetëse: Ministrinë e linjë, Mbështetja nga donatorët: GIZ")

Pas miratimit të Ligjit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, janë miratuar katër (4) akte nënligjore (Rregullore) :

Jan formuar katër (4) grupe punuese për katër (4) Rregulloret që derivojnë nga Ligji, janë organizuar 4 puntori, takime të rregullta, dhe procedurat tjera deri në finalizimin final si dhe miratimin në qeveri për rregulloret e cekura më poshtë:

- Rregullore për menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar.
<https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,25#>
- Rregullore për themelimin, organizimin, funksionimin dhe monitorimin e Qendrave për zhvillim rajonal në rajonet zhvillimore.
<https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,25#>
- Rregullore për standardet, metodologjinë dhe sistemin e hartimit dhe monitorimit të Planeve Operacionale për zhvillim rajonal të rajonave zhvillimore.
<https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,25#>
- Rregullore për performancë rajonale dhe monitorim të zhvillimit socio - ekonomik rajonal të balancuar.
<https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,25#>

Gjatë vitit 2024 është finalizuar edhe Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MZHR (janë mbajtur takime të rregullta me grupin punues deri në finalizimin e kësaj rregullore).

<https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,25#>

Veprimi- 1.1.2 Hartimi i dokumentit shpjegues të legjislacionit për zhvillim rajonal të balancuar;

("Institucioni Kryesor: MZHR: Institucione mbështetëse: Ministrinë e linjë, ZKM, MF, ASK")

Ky dokument është planifikuar që në vitin 2025 të bëhet rishikimi i tij të formohet grupi punues dhe pastaj të finalizohet si dokument.

Objektivi specifik 1.2. -Themelimi i mekanizmave institucional për hartim, monitorim, dhe vlerësim të programeve/projekteve dhe performancës rajonale;

Veprimi -1.2.1 Zhvillimi i Sistemit SPSS për matjen e performancës rajonale.

("Institucioni Kryesor: MZHR")

DPAR/MZHR në bashkëpunim me USHAF aplikohet sistemi SPSS si format për matjen e performancës rajonale. Janë kërkuar personat kontaktues nga ministritë dhe institucionet tjera të linjes. Institucionet që kanë deleguar përfaqësuesit e tyre janë MASHTI, MBPZHR, ME, MKK, MMPHI, MINT, MPB, ndërsa ato që nuk kanë deleguar përfaqësues janë, MFPT, MKRS, MAPL, MSH, ASK, ARPK, dhe KMM. Me personat kontaktues të deleguar, është mbajtur punësoria për aftësimin e tyre për futjen e të dhënave në sistem/share folder, të njëjtit kanë aplikuar share folderin për futjen e të dhënave. Me institucionet tjera, ende vazhdojmë me komunikim elektronik për caktimin e zyrtarëve kontaktues nga ana e tyre. Nga MZHR, për këtë sistem janë trajnuar shtatë (7) zyrtar.

DPKZHR/MZHR ka krijuar grupet punuese për hartimin e Udhëzuesve dhe materjaleve përcjellëse për të gjitha Programet e Zhvilluara nga MZHR, sikur që janë formuar komisionet vlerësuese dhe ekipet e Monitorimit të Projekteve.

Veprimi -1.2.2. Zhvillimi i sistemit për matjen e performancës rajonale;

("Institucioni Kryesor: MZHR, Komunitat")

DPAR/MZHR, në vitin 2024 ka krijuar "Sistemin për Matjen e Performancës Rajonale", i cili është shumë i rëndësishëm për institucionin për të mbledhur, analizuar dhe krahasuar performancën në zhvillimin socio-ekonomik rajonal, si dhe duke përdorur të dhëna të përmbledhura nga institucionet në nivel qendror dhe lokal, ofron mundësi të avancuara për të matur dhe monitoruar performancën rajonale. Është instaluar sistemi në serverët e ASHI-së, në proces të skanimit dhe testimit të sigurisë.

<https://spr.rks-gov.net/>

OBJEKTIVI STRATEGJIK: 2. ZHVILLIM RAJONAL I BALANCUAR DHE RAJONE TË AFTA PËR KONKURRENCË NDËR RAJONALE

Objektivi specifik 2.1 - Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioritetëve në baze të vlerësimeve.

Veprimi – 2.1.1 Analizës e Investimeve Kapitale sipas rajoneve zhvillimore për vitin 2023;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

DPAR/MZHR, ka realizuar Analizën për Investime Kapitale sipas rajoneve zhvillimore për vitin 2023, duke u fokusuar në pasqyrimin e investimeve kapitale në kontekstin e zhvillimit socio - ekonomik rajonal, e cila është një ndër kategoritë më të rëndësishme të shpenzimeve buxhetore. Për herë të parë, kjo analizë ofron një pasqyrë të plotë të planifikimit dhe realizimit të investimeve kapitale për vitin 2023, duke përfshirë të dhëna nga të gjitha organizatat buxhetore si nga niveli qendror ashtu edhe nga ai lokal. Poashtu, analiza për herë të parë fokusohet në ndarjen dhe pasqyrimin e investimeve kapitale të Republikës së Kosovës në kontekstin e zhvillimit socio - ekonomik rajonal, sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore të Kosovës: Qendër, Veri, Perëndim, Jug, Juglindje, Lindje dhe Jugperëndim, brenda këtij kuadri, shqyrtohen aspektet kryesore, përfshirë:

- Kontributin e ministrive dhe komunave në financimin e projekteve kapitale sipas rajoneve.
- Sektorët kryesorë të përqëndrimit të fondeve dhe pabarazitë në shpërndarjen e tyre.
- Vlerësimin e investimeve për kokë banori, si nga niveli qendror, ashtu edhe nga niveli lokal, bazuar në regjistrimin e popullsisë në vitin 2024 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Rekomandimet e dala nga Analiza e Investimeve Kapitale sipas rajoneve zhvillimore për vitin 2023, janë:

1. Gjithëpërfshirje dhe balancim të rajoneve për investime kapitale nga niveli qendror në nivel lokal;
2. Gjithëpërfshirje dhe balancim të shpërndarjes së investimeve kapitale në realizimin e projekteve në komuna brenda rajoneve zhvillimore;
3. Identifikimi i investimeve kapitale sipas nevojave dhe kërkesave të komunave, për projektet të cilat nuk mund të mbulohen nga të hyrat vetanake të komunave;
4. Rritje të buxhetit në sektorët specifik me ndikim dhe potencial të zhvillimit socio - ekonomik rajonal, siç është turizmi, digjitalizim, efikasitet dhe energjisë;
5. Zhvillimin e infrastrukturës publike, duke krijuar një mjedis të favorshëm dhe të qëndrueshëm për bizneset dhe investimet private;
6. Përmirësimi i infrastrukturës publike, që mundëson përmirësimin e transportit, energjisë dhe shërbimeve të tjera publike të cilat ndihmojnë në lidhjen e rajoneve dhe lehtësimin e lëvizjes së mallrave dhe njerëzve, si dhe rritjen e çasjes në shërbime bazë për komunitetin, me theks në komunat apo vendbanimet më pak të zhvilluara.

<https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/7B7A7EB2-ACA7-4412-B0AD-DB9AF671E158.pdf>

Veprimi - 2.1.2. Identifikimi i investimeve publike nga niveli qendror sipas rajoneve zhvillimore, zbërthyer edhe sipas komunave;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MAPL)

MZHR ka dizajnuar kriteret për ndarjen e granteve në bashkëpunim me komunat për përmirësimin e infrastrukturës publike (Investime kapitale) :

- Ndërtimi i Tregut të Gjellbërt " në Komunën Podujevës, Shuma e paguar nga MZHR - 200,000.00 €;
- "Ndërtimi i parkut rekreativ në Sllatinë të vogël" në Komunën Fushë Kosovë, Shuma e paguar nga MZHR - 70,000.00 €;
- Ndërtimi i "Udhës së Gurit", Komuna Vushtrri, Shuma e paguar nga MZHR - 120,000.00 €;
- "Ndërtimi i çerdhes për fëmijë - Vazhdimi i aneksit të dytë" Komuna Skenderaj, Shuma e paguar nga MZHR - 209,981.65 €;
- "Afaltimi i rrugës Llugagji-Jabllanicë e Gjakovës" Komuna Pejë, Shuma e paguar nga MZHR - 120,000.00€;
- "Zgjerimi i infrastrukturës në Zonën Ekonomike në Istog" Komuna Istog, Shuma e paguar nga MZHR - 70,000.00 €;
- "Zhvillimi i turizmit në komunën e Deçanit - Produktet turistike në fshatin Alpin Bjeshkatarë" në Komunën Deçan, Shuma e paguar nga MZHR - 53,350.00 €;
- "Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë, faza II" Komuna e Klinës, Shuma e paguar nga MZHR - 140,000.00 €;
- "Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe këndin e lojrave për fëmijë" në Komunën Dragash, Shuma e paguar nga MZHR - 55,000.00 €;
- "Krijimi i infrastrukturës rekreative-sportive në zonën turistike Neredime-Jezerc" Komuna e Ferizajit, Shuma e paguar nga MZHR - 80,000.00 €;
- "Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes (Faza II)" Komuna Shtime, Shuma e paguar nga MZHR - 140,000.00 €;
- "Asfaltimi i rrugës 'Ekzodi 99' "Komuna Hani i Elezit, Shuma e paguar nga MZHR - 80,000.00 €;
- "Renovimi i objektit për inkubator biznesi" Komuna Viti, Shuma e paguar nga MZHR - 95,964.20 €;
- Ndërtimi i "Parkut të Avanturave Drenovc" në komunën Ranillugë, Shuma e paguar nga MZHR - 50,000.00 €;
- "Rregullimi i shtratit të lumit Morava e Vjetër në Kllokot" Komuna Kllokot, Shuma e paguar nga MZHR - 150,000.00 €;
- "Renovimi i objektit të N.P.L. Stacioni i autobusëve Gjakovë" Komuna Gjakovë, Shuma e paguar nga MZHR - 93,850.80 €;
- "Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit" Komuna e Rahovecit, Shuma e paguar nga MZHR - 130,000.00 €.

MAPL – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MAPL për vitin 2024 ka realizuar 33 projekte nga programet si në vijim:

- Nga programi "Bashkëfinancimi me donatorë për skemën e granteve të bazuar në performancën komunale" janë planifikuar për investime kapitale vlera prej 4,000,000.00€, ndërsa është shpenzuar vlera prej 3,284,776.87 € ose 82.12%, bazuar në procedurat e implementimit si në vijim:

- Vlerësimi i performancës së vitit 2023 për grantin e performancës komunale për vitin fiskal 2024
- Marrëveshjet për mbështetje financiare janë nënshkruar për komunat përfituese nga Granti i performancës me datën 06.08.2024,
- Zotimi i mjeteve është bërë me datën 02.04.2024

Marrëveshja për mbështetje financiare përcaktojnë obligimet e palëve nënshkruese sipas nenit të Marrëveshjes - obligimet e komunave, këto të fundit obligohen të zhvillojnë procedurat e prokurimit sipas legjislacionit në fuqi.²

Nga programi “Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal” janë planifikuar për investime kapitale vlera prej 50,000.00 €, dhe është shpenzuar vlera totale prej 50,000.00 € ose 100%, bazuar në procedurat e implementimit si në vijim:

- Marrëveshjet e për mbështetje financiare janë nënshkruar më 09.07.2024,
- Zotimi i mjeteve është bërë më 03.09.2024, për shkak të zbatimit të ligjit me Nr. 08/L- 193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 konkretisht neni 14 - Shpenzimet e paparashikuara dhe rezervat,
- Marrëveshja për mbështetje financiare ka përcaktuar obligimet e palëve nënshkruese sipas Nenit të Marrëveshjes - obligimet e komunave, këto të fundit obligohen të zhvillojnë procedurat e prokurimit sipas legjislacionit në fuqi.
- Nga programi “Mbështetja për projektet infrastrukturore për komunitete në Komunitet në Republikën e Kosovës” janë planifikuar për investime kapitale vlera prej 800,000.00 € ndërsa është shpenzuar vlera prej 614,853.75 € ose 76.86%, bazuar në procedurat e implementimit si në vijim:
- Marrëveshjet për mbështetje financiare janë nënshkruar 11.07.2024 dhe 03.09.2024
- Zotimi i mjeteve është bërë me datën 16.07.2024,
- Marrëveshja për mbështetje financiare ka përcaktuar obligimet e palëve nënshkruese, sipas nenit të Marrëveshjes - obligimet e komunave, këto të fundit obligohen të zhvillojnë procedurat e prokurimit sipas legjislacionit në fuqi.

Objektivi Specifik: 2.2 - Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik;

Veprimi -2.2.1 Analiza e Zhvillimit Socio – Ekonomik Rajonal të Balancuar (përkrahja e sektorit privat), për vitin 2023;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

DPAR/MZHR, ka realizuar dokumentin analitik “Analiza e Zhvillimit Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar në Kosovë” për vitin 2023, bazuar në implementimin e “Programit për Zhvillim

Rajonal të Balancuar“ nga Ministria e Zhvillimit Rajonal gjatë vitit 2023 si dhe bazuar në implementimin e programeve me ndikim në zhvillim socio-ekonomik nga Ministritë e Linjes. Duke u bazuar në ngjashmërinë e programeve lidhur me kualifikueshmerinë e llojeve të bizneseve (mikro, të vogla dhe të mesme) dhe sektorëve (prodhim dhe shërbim) në të cilët janë përkrahur bizneset nga ministritë e linjës për vitin 2023, në këtë analizë janë shtjelluar edhe thirrjet për mbështetje të bizneseve të financuara nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Këtë vit është pasqyruar edhe programi i mbështetjes së sektorit privat edhe nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK).

Në këtë analizë realizimi i programeve për përkrahjen e bizneseve për v.2023 është trajtuar sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore nga pesë (5) sa ishin më parë, përfshirë:

- Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2023) realizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR);
- Programi për përkrahjen e NMVM-ve v.2023, i realizuar nga (KIESA/MINT);
- Programi për subvencionim nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) për vitin 2023;
- Programi në mbështetje të sektorit privat 2023 nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK).

Rekomandimet e dala nga Analiza e Zhvillimit Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar për vitin 2023:

1. Rritje të buxhetit të financimit të projekteve nga Skema e Granteve të sektorit privat nga MZHR dhe Ministritë e Linjës që mbështesin sektorin privat;
2. Harmonizim të Programeve ndërmjet MINISTRITË E LINJËS për sektorit privat nga Skema e mbështetjes përfshirë shpërndarjen, sektorin, etj.
3. Balancim të financimit në komunat e vogla brenda rajonit përmes shpërndarjes së balancuar sipas shkallës së zhvillimit të rajonit.
4. Avancimi i kategorisë Start Up, qëndrueshmeria e bizneseve në këtë kategori (mbetet kategoria më e kërkuar);
5. Financimi i paisjeve të bëhet sipas veprimtarisë së projektit brenda sektorit;
6. Financimi i projekteve sipas sektorit me potencial rritjeje bazuar në rajonin përkatës;
7. Promovimi i programit PZHRB tek komunat e vogla, komunitetet joshumicë dhe nxitjen e grave ndërmarrëse më shumë, për shkak që numri i aplikimeve është i vogël dhe rrjedhimisht edhe numri i perfitueseve.
8. Të mbështeten projektet nga Programi i OJQ-ve të cilat kanë ide-projekte të promovimit të programit PZHRB tek këto grupe.
9. Përcaktimi më konkret i veprimtarive (sektorit prodhim-shërbim) në thirrjen për mbështetjen e sektorit privat.

<https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/3B7D64EF-813E-42B1-B53E-475D3CB3E91B.pdf>

Veprimi -2.2.3 Hartimi dhe Implementimi i programit të zhvillimit rajonal me grante për komuna për përmirësimin e infrastrukturës publike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

Janë dizajnuar kriteret për grante në infrastruktur publike, është hapur thirrja publike për aplikim.

Është kontraktuar kompania mbikqyrëse për monitorim dhe raportim lidhur me implementimin e granteve në infrastrukturës publike, kontratë kjo që mban nr. 221-24-7167-2-2-1/C102 OE ky që vazhdimisht ka hartuar raportet periodike lidhur me implementimin e programit për zhvillim rajonal në përmirësimin e infrastrukturës publike.

MZHR në vitin 2024 gjithsej ka realizuar 19 projekte në 19 komuna të Republikës së Kosovës. Shuma e financuar për vitin 2024 ka qenë në vlerë 1,986,924.76 euro.

MZHR ka raportu këto investime kapitale në pesë (7) rajone zhvillimore për vitin 2024:

1. *Rajoni Zhvillimor Qendër: Podujeva, Drenasi dhe Fushë Kosovë,*
2. *Rajoni Zhvillimor Veri: Vushtrri dhe Skenderaj,*
3. *Rajoni Zhvillimor Perëndim: Pejë, Istog, Klinë dhe Deçan.*
4. *Rajoni Zhvillimor Jug: Dragashi,*
5. *Rajoni Zhvillimor Juglindje: Ferizaj, Shtime, Hani i Elezit dhe Kaçanik,*
6. *Rajoni Zhvillimor Lindje: Viti, Klllokot. Ranillug,*
7. *Rajoni Zhvillimor Rajoni Jugperëndim: Gjakovë dhe Rahovec,*

Veprimi -2.2.4 Hartimi dhe Implementimi i programit për zhvillim rajonal të balancuar me grante në sektorin privat;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)


Janë dizajnuar kriteret për grante në sektorin privat, është hapur thirrja publike për aplikim, janë krijuar ekipet monitoruese për monitorim dhe raportim lidhur me implementimin e granteve për biznese në sektorin privat, janë hartuar raportet periodike lidhur me implementimin e programit për zhvillim rajonal në sektorin privat.

Në vitin 2024 nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (Përkrahja e bizneseve PZHRB 2024): nga 1424 Projekt Propozime që kanë aplikuar , janë nënshkruar kontratat në mes të përfituesve dhe MZHR-ë për 139 Projekt Propozime. Mjete e destinuar për këtë thirrje kanë qenë në shumën prej: 1,715,737.00 €.


<https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,35#>

<https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,35#>

Shpërndarja me grafikon në % e përkrahjes së bizneseve PZHRB 2024




Shpërndarjen e investimeve financiare për secilën kategori për vitin 2024



Grafiku që paraqet përqindjen e investimeve për secilën kategori për vitin 2024

Përqindja e Investimeve Financiare sipas Kategorive 2024



<https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,7,2024,1383>

Objektiv Specifik: 2.3 - Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Veprimi -2.3.1 Udhëzuesin për Identifikimin e Zonave për Investime Strategjike dhe Studimi i Fizibilitetit për Zhvillim Rajonal;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR-MINT)

DPAR/MZHR, në koordinim me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka hartuar dhe miratuar Udhëzuesin për Identifikimin e Zonave për Investime Strategjike dhe Studimi i Fizibilitetit për Zhvillim Rajonal. Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë një kornizë të qartë dhe të strukturuar për identifikimin e zonave me potencial të lartë për investime strategjike në rajonet zhvillimore dhe kryerjen e studimeve të fizibilitetit për projektet investive në këto zona. Procesi i identifikimit përfshin analizën e një sërë faktorësh ekonomikë, social dhe mjedisorë që përcaktojnë potencialin për zhvillim. Përderisa, studimi i fizibilitetit do të ndihmojë në vlerësimin e mundësive dhe sfidave të këtyre investimeve, duke siguruar që projektet të jenë të realizueshme dhe të kenë ndikim pozitiv në zhvillimin socio - ekonomik rajonal.

Për zbatim të suksesshëm dhe realizim praktik në rajonet zhvillimore, në këtë udhëzues janë trajtuar në hollësi qështjet si në vijim:

Pjesa hyrëse, objektivat e studimit, metodologjia e studimit, roli dhe rëndësia e identifikimit të zonave për investime strategjike dhe studimi i fizibilitetit për zhvillim socio - ekonomik rajonal,

kriteret për identifikimin e zonave, studimi i fizibilitetit të projekteve për investime në zonat e identifikuar, natyra e projekteve dhe korniza ligjore për investime strategjike, elementet kryesore për vlerësimin e projekteve strategjike, burimet e financimit, organizimi dhe planifikimi i strukturave organizative për zbatimin e udhëzuesit, interesat dhe përfitimet nga koordinimi i aktiviteteve të grupit koordinues në nivel qendror dhe grupeve punuese në nivel rajonal, si dhe një përministrinë e linjësedhje përfundimtare e udhëzuesit.

Veprimi -2.3.2 Hartimi i udhërrëfyesit për qasje në fonde strukturore të BE-së.; (MZHR)

Ky aktivitet është bartur për vitin 2025 pasiqë do të aplikohet në programin TAIEK (asistenc teknike) me ekspert.

Veprimi -2.3.3 Zhvillimi i programit për promovimin e politikave zhvillimore të rajoneve socio-ekonomike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MINT)

Është hartuar programi për Mbështetje të Organizatave të Shoqërosë Civile (OSHC) në kuadër të promovimit të politikave zhvillimore dhe janë zhvilluar 96 aktivitete për mundësitë e vetpunimit ku kanë përfituar rreth 530 pjesëmarrës me trajnime me temë ngritja e kapaciteteve të grave dhe të rinjëve.

<https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,37,2024,1216>

Më 16 dhe 17 prill 2024 është realizuar Konferencë dy ditore me temën *"Të Bëhemi Kreativë për Zhvillimin Rajonal"*, organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në partneritet me UN-Habitat Kosova.

Konferenca ka mundësuar shkëmbimin e njohurive, diskutimin e strategjive efektive për promovimin e politikave zhvillimore të rajoneve socio-ekonomike, eksplorimin e mundësive të bashkëpunimit me Suedinë dhe identifikimin e veprimeve të përbashkëta për të ardhmen.

Poashtu është realizuar ceremonia e ndarjes së çmimeve të dala nga aplikimi në Konkursin e Fotografisë dhe Videos "Unë e Dua Rajonin Tim" ku janë ndarë 3 çmime.

Më datë 10 - 11 tetor 2024, u mbajt Konferenca e Parë Shkencore Ndërkombëtare për Zhvillim të Qëndrueshëm Rajonal, e organizuar nga Instituti i Kërkimit Shkencor për Zhvillim të Qëndrueshëm, Kosovë (IKSZ) e mbështetur nga Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

Realizimi i kësaj konference reflekton përkushtimin e MZHR-së për të nxitur politikën dhe strategjitë që përfaqësojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar në Kosovë dhe më gjerë gjithashtu ndihmon të zhvillojmë politika të reja që përballen me sfidat e tranzicionit demografik deri në vitin 2050.

Tema kryesore e konferencës ishte “Tranzicioni Demografik në 2050 dhe Politikat Rajonale”, temë e cila tërhoqi pjesëmarrjen e një numri të madh studiuesish, akademikësh, profesorësh dhe përfaqësues të institucioneve nga brenda dhe jashtë vendit.

Në këtë konferencë shkencore u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit në mes Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë dhe Universitetit të Rijekës Kroaci, marrëveshje e arritur fal angazhimit dhe vizitës zyrtare nga përfaqësuesit e MZHR-së në muajin Maj 2024 në Kroaci.

Objektivi Specifik: 2.4 - Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonal përmes programeve trans nacionale;

***Veprimi -2.4.1** Përgatitja e plan programit për anëtarësim dhe kërkesa për anëtarësim ne programet: BALKANMED, ADRION dhe DANUB;*

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MPJD)

Ministri i MZHR-së bashku me stafin e lartë drejtues ka mbajtur takim në Bruksel me përfaqësuesit e **DG Regio, Komitetin Evropian të Rajoneve dhe Zyren e Komisioneres për Reforma dhe Kohezion** të programeve Euromed, Adrion dhe Danub, ku për arsye që shtetet e BE-së nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës nuk kemi mundur të anëtarsohemi në këto programe.

***Veprimi -2.4.2.** Përgatitja e planit të bashkëpunimit me sekretariatet e programeve trans nacionale: BALKANMED, ADRION dhe DANUB;*

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

Për arsye që MZHR nuk është anëtarësuar në këto programe nuk ka përgatitur një plan të bashkëpunimit me këto sekretariate.

OBJEKTIVI STRATEGJIK: 3. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM RAJONAL BAZUAR NË RESURSE NATYRORE, EKONOMIKE, KULTURORE DHE HUMANE

Objektivi specifik- 3.1 - Resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane të qëndrueshme dhe te promovuara;

Veprimi - 3.1.1. Pasqyrimi i resurseve natyrore sipas rajoneve zhvillimore;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

DPAR/MZHR, ka realizuar dokumentin: “Pasqyrimi i Resurseve Natyrore Sipas Rajoneve Zhvillimore”, në koordinim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor

dhe Infrastrukturës (MMPHI), Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), Institutin për Mbrojtjen e Natyrës (IMN). Përmes hartimit të këtij dokumenti, MZHR synon të paraqesë një pasqyrë të resurseve natyrore për shtatë (7) rajonet zhvillimore të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij dokumentit është të ndihmoj hartuesit e politikave në zhvillimin e tyre kundrejt vetëdijësimit, mbrojtjes, së resurseve ekzistuese natyrore dhe shfrytëzimit të tyre për fusha tjera siç është zhvillimi ekonomik/turizmi dhe ndikimi drejt një zhvillimi socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Resurset natyrore përbëjnë një prej burimeve me shumë rëndësi në zhvillimin ekonomik në Kosovë përmes shfrytëzimit të këtyre burimeve natyrore duke ndikuar në zhvillim ekonomik dhe përmirësim të mirëqenies sociale. Në këtë dokument janë pasqyruar toka me karakteresitikat e saj si: (tokë bujqësore, pyje, bimësia, tokë urbane, kullotat, ujëra, si dhe të tjera)¹, të pasqyruara me sipërfaqe Ha në komunat e rajoneve zhvillimore të Kosovës. Gjithashtu në këtë analizë në detaje janë pasqyruar ujërat² dhe zonat e mbrojtura³, sipas komunave në 7 rajone zhvillimore.

Lista e aseteve të resurseve natyrore është pasqyruar me:

Llojin e resursit natyror, emërtimin e resursit natyror, sipërfaqen, gjatësinë, kapacitetin, vendndodhjen e resurseve natyrore, të tjera.

<https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/570A4F8F-5E8B-478A-B1FC-6CF57CE230C5.pdf>

<https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/2B44D6F1-632C-42BC-89BE-1CC07AAF8314.pdf>

Veprimi - 3.1.2. Pasqyrimi i resurseve ekonomike sipas rajoneve zhvillimore;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

DPAR/MZHR, ka përgatitur dokumentin: "Pasqyrimi i Resurseve Ekonomike Sipas Rajoneve Zhvillimore". MZHR/DPAR në koordinim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë (ME), përmes hartimit të këtij dokumenti, synon të paraqesë një pasqyrë të resurseve ekonomike për shtatë (7) rajonet zhvillimore të Republikës së Kosovës. Qëllimi i dokumentit është që përmes pasqyrimit të potencialit të resurseve ekonomike të ndihmoj hartuesit e zhvillimit të politikave rajonale drejt hartimit të programeve për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar duke u bazuar në resurse ekzistuese ekonomike siç janë sektori minerar, zhvillimi në fushën e energjisë, rëndësia dhe roli i ndërmarrjeve publike si dhe telekomunikacioni.

Ky pasqyrim ofron qasje të lehtë në identifikimin e potencialeve, resurseve ekonomike në baza rajonale (komuna) për të gjithë investitorët dhe akterët tjerë relevant, grupet e interesit për mundësi zhvillimi në të mirën e përgjithshme.

Asetet e resurseve ekonomike të trajtuara në këtë dokument janë:

1. Lista e aseteve të resurseve minerare është pasqyruar me:

Llojin e resursit mineral ekonomik, emërtimin e resursit mineral, periudhën ekzistuese, kapacitetin, vendndodhjen e resurseve ekonomike minerare.

2. Lista e aseteve të resurseve energjetike përmban:

Llojin e resursit energjetik ekonomik, emërtimin e resursit energjetik, periudhën ekzistuese, kapacitetin, vendndodhjen e resurseve ekonomike energjetike.

3. Lista e aseteve (ndërmarrjeve publike) përmban:

Llojin e ndërmarrjes, emërtimin e ndërmarrjes publike, periudhën ekzistuese, kapacitetin, vendndodhjen e ndërmarrjes ekonomike.

<https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/252BE2DC-A1FD-4FB8-ACA8-27CC1CDF32C0.pdf>

<https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/35099255-C544-4899-AB8D-E7EC0AFED849.pdf>

Veprimi - 3.1.3. Pasqyrimi i resurseve kulturore sipas rajoneve zhvillimore;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

DPAR/MZHR në koordinim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MRKS), ka realizuar dokumentin pasqyrimi i resurseve kulturore sipas rajoneve zhvillimore, i cili synon të paraqesë një pasqyrë të resurseve kulturore për shtatë (7) rajonet zhvillimore të Republikës së Kosovës. Qëllimi i dokumentit është të ndihmoj hartuesit e programeve dhe zhvillimin e politikave drejt ruajtjes së vlerës së resurseve ekzistuese kulturore dhe shfrytëzimit të tyre në fushat me ndikim ekonomik, zhvillimit të turizmit dhe ndikimit drejt një zhvillimi socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Këto resurse janë pasqyruar në bazë të burimit historik, strukturës, vendit, objektit, veçorisë ose në njësi historike lokale. Përveç identifikimit të vendndodhjes dhe gjendjes aktuale të resurseve kulturore, pasqyrimi i resurseve në rajone zhvillimore është proces shumë i rëndësishëm i cili kontribuon në menaxhim efektiv dhe mbrojtjen e tyre. Pasqyrimi i tillë ndihmon edhe në promovimin dhe ruajtjen e vlerës së aseteve kulturore, promovimin tek aktet tjerë dhe organizata të ndryshme me qëllim nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Asetet e trajtuara në këtë dokument janë:

1. Trashëgimia kulturore me mbrojtje të përhershme e cila karakterizohet dhe është paraqitur në disa kategori si:

- a. trashëgimia arkeologjike: (monument, ansambël), (lokalitet arkeologjik/rezervat);
- b. trashëgimia arkitekturore: (monument/ansambël).

Një resurs kulturor është i paraqitur përmes: emërimit, kategorisë/fushës, periudhës ekzistuese, statusit, komunës, rajonit.

2. Trashëgimia kulturore me mbrojtje të përkohshme e cila karakterizohet dhe është paraqitur në disa kategori si:

- a. trashëgimia arkeologjike: (monument, ansambël), (lokalitet arkeologjik/ rezervat);
- b. trashëgimia arkitekturore: (monument/ansambël), (fushat e konservimit arkitekturor);
- c. objektet e luajtshme;
- d. peisazhet kulturore;
- e. trashëgimia shpirtërore.

3. Objektet tjera kulturore

<https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/61A6284B-6499-431A-9AC7-C2B9680E631A.pdf>

<https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/E0FAE99F-B1B3-49D2-B626-49FA85ACBE83.pdf>

Objektivi specifik – 3.2. Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancua;

Veprimi - 3.2.1. Koordinimi i aktiviteteve me MINT dhe ministrit e linjes, për hartimin e udhërrëfyesit për brendimin e rajoneve zhvillimore;

(Institucioni përgjegjës sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR - MINT)

DPAR/MZHR, ka hartuar Udhëzuesin për brendimin e rajoneve zhvillimore i cili është një dokument i rëndësishëm që synon të ofrojë një kornizë të strukturuar dhe praktike për zhvillimin e procesit të brendimit rajonal. Në kontekstin e globalizimit dhe rritjes së konkurrencës, brendi rajonal është një instrument i domosdoshëm për forcimin e identitetit dhe vlerave të veçanta të secilit rajon, si dhe për promovimin e potencialeve dhe resurseve të tij natyrore, kulturore dhe ekonomike. Qëllimi i udhëzuesit, është të ofrojë orientime dhe metodologji të nevojshme për implementimin e suksesshëm të procesit të brendimit të rajoneve zhvillimore, duke e bërë atë një mjet të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit. Ky udhëzues ka për qëllim të ndihmojë akterët e ndryshëm, duke përfshirë institucionet publike, organizatat dhe shoqëritë civile, në krijimin e strategjive efektive për brendimin e rajoneve zhvillimore, si dhe për të siguruar që zbatimi i këtyre strategjive të jetë i qëndrueshëm dhe i orientuar nga nevojat e komunitetit.

Për zbatim të suksesshëm dhe realizim praktik në rajonet zhvillimore, në këtë udhëzues janë trajtuar në hollësi qështjet si në vijim:

Pjesa hyrëse, korniza ligjore dhe rregullative për brendimin rajonal, roli dhe rëndësia e brendimit rajonal dhe mënyra e përdorimit, objektivat strategjike, metodologjia e zbatimit, organizimi i grupeve punuese, fazat e zbatimit dhe realizimit, ndikimi i brendit rajonal në zhvillimin socio – ekonomik të rajoneve, karakteristikat dhe potenciali rajonal, kriteret dhe specifikat për vlerësimin dhe zhvillimin e brendit rajonal, krijimi i brendit rajonal, zyrtarizimi dhe mbrojtja ligjore e brendeve rajonale për zhvillim të qëndrueshëm, roli i nivelit qendror në përdorimin dhe promovimin e brendit rajonal, burimet e financimit dhe përmbledhja përfundimtare.

<https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,50#>

Objektivi Specifik: 3.3 - Ndërtimi i kapaciteteve humane dhe OSHC-ve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik rajonal;

Veprimi - 3.3.1 Ngritja e kapaciteteve humane të nivelit lokal për shfrytëzimin e resurseve natyrore, përmes përkrahjes financiare;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes Thirrjes Publike që realizon çdo vit për mbështetjen financiare të projekteve/programeve të QJQ-ve për avancimin e zhvillimit socio ekonomik rajonal të balancuar ka mbështetur Organizata Joqeveritare të udhëhequra nga gratë edhe të rinjët, me një numër të mirë të projekteve. Në total janë financuar 61 projekte për vitin 2024 me vlerë 241,090.00 euro.

Më poshtë gjeni tabelën e përfituesëve me emrat e projekteve:

Nr.	Lista e aplikimeve nga OJQ-të	Titulli i projektit
1	Agjencia për Zhvillim Rajonal Veri - AZHR	"Zhvillimi i qëndrueshëm përmes iniciativave strategjike të zhvillimit rajonal
2	Agjencia për Zhvillim Rajonal Qendër - AZHR	"Promovimi i Politikave të zhvillimit të Qëndrueshëm në fushën e Prodhimit në rajonin Qendër "
3	AZHR - Jug	Promovimi i Zhvillimit Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar përmes zhvillimit të kapaciteteve rajonale për aplikim në skema të grantëve për OJQ dhe Biznese
4	AZHR Perëndim	Ngritja e kapaciteteve në rajonin perëndimor për zbatimin e politikave të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar
5	Agjencia për Zhvillim Rajonal Lindje - AZHR	Promovimi i turizmit në rajonin Lindje
6	Kosova Genc Birlik Dernegi - KGBD	Kosova Genç Birlik Dernegi
7	Centar za afirmaciju ministritë e linjësadih gracanica CZA	Ministritë e linjësadi umetnici Web Dizajn I Tehnologjia
8	Sakuntala	Ngritje e kapaciteteve profesionale dhe e punësimit të të rinjeve të komuniteteve ashkali, rom dhe egjiptian
9	Asociacioni I gruas Feminae	Gruaja Kosovare ne Akcion
10	Practice Youth P.Y.	Ruralni Razvoj 2025
11	Shoqata e Mediave Turke të Kosovës SHMTK	Jam e zoja në shumë fusha - Her tezgahata bezim var
12	IDEA	Avancimi dhe zhvillimi socio-ekonomik në sytë e të rinjëve
13	EQUALITY	Unapredjenje socio-eknomskog polozaja kroz promociju ruralnih kapaciteta svi zaedno za zlata sela
14	Kosova Turkiye Mezunlari Dernegi - TUMED	Sosyo Ekonomik Kaldinma için Egitimler/ Trajnimet për Zhvillim sovio-Ekonomik
15	Center za mir I toleranciju - CMTP	Mladi umentnic Web dizajn Tehnologjia
16	Natural Fresh	Samozaposljavanje I samostalna zena za jaku lokalnu zajednica

17	Centar za depolitizaciju kosovkog drustva CDKD	Opste Informacije o aplikantu ,projektu I partnerima osnove informacije za organizaciju aplikanta I partnera
18	D&D Business Suport Center	Otaranje poslovnih mogucnosti za zene kros razvoj turizma u Regionu Gnjlana
19	Women World Today and Now	Ngritja e kapaciteteve të rinjëve në Ndërmarrësi
20	Instituti Optimun	Ngritja e kapaciteteve të rinisë me qëllim të rritjes së zhvillimit ekonomik dhe social
21	A vision for building a future	Resurset socio-ekonomike të Rajonit Zhvillimor Veri dhe promovimi i bashkëpunimit në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar
22	North Youth Movement - NYM	Hulumtimi i mundesive per bashkepunim me qellim te avancimit te bashkepunimit ne fushen e zhvillimit socio ekonomik rajonal te balancuar
23	Diagrami	Rritja e Aftësive të Buta të Rinjtë-Inkurajimi për Ngritje e Kapaciteteve nr Zhvillimin Socio-Ekonomik Rajonal
24	Kosovo Experts Group - KEG	Avanancimi Profesional dhe Ngritje Socio -Ekonomike
25	Progresi dhe Avancimi Rinor në Kosovë - PARKS	Prespektiva e perbashket
26	Qendra për hapat rinor QeHR	Femra si shtyllë e fuqishme e shoqërisë dhe e familjes dhe fuqi punëtore e kualifikuar e cila ndikon në zhvillimin socio-ekonomik në shoqër
27	Qendra për rini të avancuar	Sipërmarresit e rinj te komunes se Vushtrise
28	Business Menagement Training Centre - BMTC	Promovimi I politikave të fushës së zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar
29	Instituti për Hulumtime dhe Analiza Sociologjike - IHAS - Sociometri	Avancimi i zhvillimit socio-ekonomik rajonal në Rajonin e Mitrovicës
30	Humanus Vita	Fuqizimi i grave ndërmarrëse në politikat e zhvillimit ekonomik
31	Iniciativa e Femrës Kosovare - IFK	Rritje dhe Barazi:Nxitje e Zhvillimit Socio-Ekonomik Rajonal
32	Instituti 'IKSZQ'	Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm Rajonal,(Ekonomik-Social-Mjedisor-Kulturor), me temë: "Tranzicioni Demografik në vitin 2050 dhe Politikat Rajonale" në Prishtinë
33	Oda e Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës	Promovimi I politikave të fushës së zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar
34	Bosnjacko Oministritë e linjësadinski Klub - BOK	Mladi preduzetnici u socio-ekonomskom razvoju zupe

35	Youth Education Center	Komuna dhe te rinjete
36	Creative Center	Grua ekonomisht e fuqishme, grua e pavarur
37	Tourism and Agriculture Development Fund TAD-F	Sveubuhvatni rivredni razvoj regiona planine sar, kroz kreiranje mreza investitora, poslovnih udruzenja, turistickih operatera i poljoprivrednih proizvojdjaca
38	Organizata Multietnike e Personave me Aftësi të Kufizuara - OMPAKL	Përkrahja e femrave me aftësi të kufizuara
39	Handikos - Lipjan	Bota i përket teknologjisë me Aftësi të Kufizuara Fizike dhe të Kombinuara për tregun e punës
40	Alternativa Rinore për Progres - ALRP	Bota I përket teknologjisë, përgatitje e të rinjeve me aftësi të kufizuara për tregun e punës
41	Instituti për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë - IFPR	Të rinjët dhe gratë me gratë me kapacitete të ngritura në fushën e zhvillim socio-ekonomik
42	Global Development Solutions - GLOBEDS	Avancimi I të rinjëve të komuniteteve Ashkali ,Egjiptian dhe Rom në tregun e punës
43	Tourism and Marketing Institute - TMI	Avancimi socio-ekonomik dhe zgjerimi I Zhvillimit Rajonal
44	POLIS	Hartimi I projekt propozimeve, Biznes Planeve për aplikim në institucionet vendore dhe ndërkombëtare nga të rinjtë në Republikën e Kosovës
45	OMNES	
46	Center for Cooperation and Networking of Organization	Zhvillimi aftësive për udhëheqëse dhe liderë komunitarë në ndërmarrësi
47	PONTIS/Ura	Fuqizimi I bashkëpunimit në mes të komunave dhe shoqatave të biznesit dhe ofrimi I rekomandimeve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në regjionin e Ferizajit
48	GLV Natyra	Fuqizimi I rolit të grave dhe të rinjeve në ndërmarrësi
49	Forumi Shqiptar i Diasporës	Qendra për Hulumtimin dhe Politikë Gjinore-QHPGJ
50	Qendra për Hulumtime dhe Politikë Gjinore - QHPGJ	Projekti International Display
51	Local Democratic Agency of Kosovo – LDA Kosovo	Projekti International Display
52	Qendra për edukim - Reforma	Zhvillimi socio-ekonomik në nivel lokal-Komuna Lipjan
53	Retina	Identifikimi i mundësive të bashkëpunimit në fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal
54	GURMANIA	Bashkëpunimi për Zhvillimin Rajonal në Fushë Kosovë dhe Oboliq
55	Research - RCH	Promoivimi si mjet kyç për avancim e qëndrueshmërisë socioekonomik

56	Qendra për Edukim, Inovacion dhe Zhvillim Profesional AKADEMIA	Zhvillimi I qëndrueshëm rajonal përmes identifikimit të fushave potenciale në e udhëhequra nga gratë
57	IFYF	Zhvillimi I qëndrueshëm rajonal përmes identifikimit të fushave potenciale në e udhëhequra nga gratë
58	Leadership Development Association Albania - LDAA	Promovimi i Zhvillimit Socio- Ekonomik Rajonal të Balancuar në konferencat LEAP-in
59	Instituti për Ekonominë e Tregut të Lirë - IETL	Rritja e kapaciteteve për zyrtarët komunalë: Trajnimi për menaxhimin e projekteve
60	POLITEIA	Komunat për Bizneset drejt zhvillimit të qëndrueshëm
61	GLV Kalaja	Mbeshtetjeje e të rinjve të komunes së Novoberdes, për zhvillimin e e shkathtësive për qasje në tregun e punës

Rajoni Zhvillimor Qendër

Organizimi i sesioneve informuese në komuna lidhur me skemën e granteve për biznese dhe start up të lansuara nga MZHR.

Punëtori me zyrtarë komunal në përgatitjen e projekt koncepteve komunale dhe rajonale lidhur me programin e lansuar nga MZHR për komunat.

Rajoni Zhvillimor Lindje

Bashkëpunimi MZHR-KOMUNA -AZHR

AZHR Lindje ka vazhduar të ofroj përkrahje direkte dhe indirekte të gjitha komunave të rajonit Lindje përfshirë të gjithë të interesuarit për aplikim për grante në kuadër të thirrjeve të MZHR-së për Programin për Zhvillim Rajonal të Balansuar 2024 (Thirrja për biznese dhe Investime kapitale). Si rezultat gjatë vitit 2024 janë përzgjedh dhe financuar 9 projekte të investimeve kapitale në rajonin Lindje

Sa i përket sektorit privat gjatë vitit 2024 rreth 200 biznese dhe aplikant potencial kanë ndjekur sesionet informuese në lidhje me kriteret dhe mënyrën e aplikimit ndërsa gjithsej 41 biznese kanë qenë përfituese nga thirrja e MZHR për PZHRB 2024 dhe AZHR Lindje u ka ofruar asistencë këtyre përfituesve lidhur me implementimin e suksesshëm të projekteve.

AZHR Lindje ka qenë partnere me Komunën e Parteshit në projektin “Qendra për Edukim Profesional” financuar nga BE. Ky projekt ka përfunduar me sukses gjatë vitit 2024. Në kuadër të këtij projekti 60 të rinj janë aftësuar në profesionet si: rrobaqepës, kuzhinier dhe sanitari përderisa 34 biznese (25 start-up dhe 8 biznese ekzistuese) kanë përfituar grante.

Gjatë vitit 2024 AZHR Lindje ka ofruar asistencë profesionale në përgaditjen e aplikacioneve për thirrje të ndryshme komunave dhe individëve si dhe bizneseve të reja dhe bizneseve ekzistuese për thirrje të shpallura nga burime të ndryshme të financimit (MAPL, FKEE, USAID etj).

AZHR Lindje ka ndihmuar komunat Gjilan, Kamenicë, Ferizaj dhe Hani i Elezit në përgatitjen e metodologjisë për subvencionimin e bizneseve nëpër komuna.

AZHR Lindje ka kontribuar në promovimin e sektorit privat përmes rritjes së partneritetit dhe bashkëpunimit në mes të kultivuesve, përpunuesve të ushqimit, qendrave grumbulluese, fermerëve lokalë, fidanishtet, përfaqësues të NVM dhe përfaqësues të pushtetit lokal (komunat: Kamenicë, Novobërdë, Gjilan, Ranillug, Partesh, Killokot dhe Viti) nga rajoni lindje përmes konferencës në këtë temë të mbështetur financiarisht nga PPSE, Swiss Contact.

AZHR Lindje ka kontribuar në promovimin e turizmit në rajonin Lindje me mbështetjen financiare nga MZHR përmes realizimit të 12 video prezantimeve për 11 komunat dhe 1 video të përbashkët për rajonin Lindje.

Rajoni Zhvillimor Perëndim

AZHR-Perëndim gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar të mbështet gjashtë Komunat e këtij rajoni, si dhe organizata të shoqërisë civile në procesin e zhvillimit të projekteve për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë-Mal i Zi. Konkretisht, AZHR-Perëndim ka mbështetur Sekretariatit e Përbashkët Teknik e BNK Kosovë-Mal i Zi në organizimin e trajnimeve të ndara tre-ditore gjatë Qershorit dhe Korrikut të vitit 2024 për Komunat dhe për OSHC-të, në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve sipas modelit të BE-së.

Tutje gjatë muajit Shtator 2024, AZHR-Perëndim ka organizuar tri punëtori të veçanta për Ekipet Komunale të Projekteve që përfaqësojnë gjashtë Komunat e rajonit Perëndim duke

ngritur kapacitetet për të zhvilluar projekt propozime potenciale për programin e bashkëpunimit ndërkufitar të lartcekur dhe programe të tjera të BE-së, sipas metodologjisë së BE-së për menaxhimin e projekteve.

Këto punëtori mbi ngritjen e kapaciteteve janë përcjell nga punëtori tjera gjatë muajve Tetor dhe Nëntor 2024, me OSHC, biznese dhe struktura të qeverive lokale dhe Kryetarë, mbi identifikimin e prioriteteve si pjesë e konsultimit me hisedarët e rajonit perëndim. Përtej kësaj, AZHR-Perëndim është duke zbatuar gjatë kësaj periudhe raportuese projektin "Turning our villages in tourism destinations", në partneritet me Komunën e Pejës dhe një organizatë nga Mali i Zi, projekt i financuar nga Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mal i Zi – Kosovë, me vlerë prej 456,106.76€.

Ky projekt kishte filluar në Shkurt 2023 dhe do të përfundojë në Qershor të vitit 2025. Gjatë vitit 2024, AZHR-Perëndim së bashku me Komuna dhe organizata të tjera ka aplikuar në thirrjen e fundit të programit të lartcekur, duke zhvilluar tre projekte të reja me të cilat synohet zhvillimi i mëtejshëm socio-ekonomik në rajon përmes turizmit dhe mbështetjes së komuniteteve rurale.

Deri tani ky program ka financuar mbi 20 projekte të ndryshme në këtë rajon.

Rajoni Zhvillimor VERI

Takime me kryetarët dhe drejtorët e komunave – nga rajoni i veriut, së bashku me MZHR-në, për t'i informuar më hollësisht mbi mundësitë e aplikimit në fondet e Komisionit Evropian.

Konferenca Rajonale – organizimi i konferencës "**Zhvillimi Rajonal: Përparësitë dhe Sfidat**", në bashkëpunim me MZHR, komunat dhe donatorët.

Pjesëmarrja në punëtorinë e përbashkët – me MZHR dhe TAIEK mbi Menaxhimin e Projekteve në Zhvillimin Rajonal.

Përgatitja e Strategjisë Rajonale të Zhvillimit për Rajonin Ekonomik Veri (2024-2027).

Promovimi i aktiviteteve të MZHR – në mediat sociale nga AZHR-Veri.

Promovimi i aktiviteteve të MZHR – në media nga gazeta Ditori.

Gjithashtu gjatë vitit 2024, Agjencia për Zhvillim Rajonal - Veri ka implementuar projektin "Avancimi i Barazisë Gjinore dhe Diversitetit përmes Eliminimit të Diskriminimit Gjinor në Vendet e Punës", i fokusuar në promovimin e barazisë gjinore në tregun e punës në komunat veriore financuar nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj)

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Fushata e Ndërgjegjësimimit në Rrjetet Sociale – janë publikuar 25 postime në shqip dhe serbisht mbi barazinë gjinore, të drejtat e punës dhe përfshirjen e grave në tregun e punës.
- Trajnimi për aftësi të buta – 40 gra nga komunat veriore morën pjesë në trajnimin mbi zhvillimin profesional dhe fuqizimin në tregun e punës.
- Takime me Zyrat e Punësimit – janë mbajtur 4 takime me përfaqësues të institucioneve lokale për të diskutuar mundësitë e punësimit për gratë.
- Sesione informuese me publikun – mbi programet e masave aktive të tregut të punës, ku morën pjesë:
- 82 gra dhe burra në Komunën e Zubin Potokut
- 34 gra në Komunën e Leposaviqit

Mentorim dhe mbështetje pas trajnimit – është ofruar mbështetje për gratë pjesëmarrëse përmes rrjetëzimit dhe këshillimit profesional.

Promovimi i barazisë gjinore në media – shpërndarja e informatave mbi fushatën dhe aktivitetet në rrjetet sociale dhe media lokale.

Rajoni Zhvillimor Jug - gjatë vitit 2024 kapasur këto rezultate:

- Trajnimi i tri grupeve nga 8 pjesëmarrës (gjithsej 24 pjesëmarrës) nga sektori privat për hartimin e projekt propozimeve të shpallura nga MZHR-ja
- Trajnimi i tri grupeve nga 8 pjesëmarrës (gjithsej 24 pjesëmarrës) nga sektori i shoqërisë civile për hartimin e projekt propozimeve të shpallura nga MZHR-ja.

Gjatë vitit 2024 AZHR Jug dhe Komuna e Prizrenit nënshkruan një marrëveshje të mirëkuptimit për organizimin dhe menaxhimin e skemës së granteve për vitin 2024, me titull „Mbështetja e ndërmarrjeve ekzistuese dhe atyre Start-Up në komunën e Prizrenit “. Numri total i aplikacioneve të pranuar ishte 50, me 22 aplikacione në Lot 1 (Start-up) dhe 28 në Lot 2 (Bizneset ekzistuese). Nga gjithsej 27 aplikacione që e kanë kaluar kontrollin administrativ, 23 prej tyre janë listuar si përfitues potencial, 3 janë vlerësuar me më pak se 50 pikë dhe 1 aplikant është vendos në listën rezervë.

Gjithsej vlera e mjeteve të shpërndara ishte 59,923.99 EUR.

Gjatë këtij viti AZHR Jug i asistoi komunat e rajonit jug gjatë aplikimit në fondet qeveritare, si në MZHR dhe MAPL, poashtu edhe për aplikim në programin e BE-së “CBC Kosovë – Maqedoni e Veriut”. Gjithashtu, ne zbatim ka projektet e ERPK në Prizren, Suhareke, Rahovec dhe Mamushe.

Veprimi - 3.2.2 Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve tek të rinjtë për identifikimin e mundësive të vetëpunësimit dhe krijimin e bizneseve "start up";

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Përmes programit për Mbështetje të Organizatave të Shoqërosë Civile (OSHC) janë zhvilluar 96 aktivitete nga 61 OJQ-të përfituese për mundësitë e vetpunësimit ku pjesë kanë përfituar rreth 530 pjesëmarrës me trajnime me temë ngritja e kapaciteteve të grave dhe të rinjëve.

Objektiv Specifik: 3.3 - Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Veprimi - 3.3.1 Ndarja e granteve në bashkëpunim me komunat për përmirësimin e infrastrukturës publike (Investime kapitale) të zonave ekonomike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

MZHR ka dizajnuar kriteret për ndarjen e granteve në bashkëpunim me komunat për përmirësimin e infrastrukturës publike (Investime kapitale) të zonave ekonomike dhe atë:

- "Zgjerimi i infrastrukturës në Zonën Ekonomike në Istog ku ky projekti parasheh zgjerimin e infrastruktures në këtë zonë" Komuna Istog, Shuma e paguar nga MZHR - 70,000.00 €,
- "Renovimi i objektit për inkubator biznesi" Komuna Viti, Shuma e paguar nga MZHR - 95,964.20 €,
- "Ndërtimi i Tregut të Gjellbërt " në Komunën Podujevë, Shuma e paguar nga MZHR - 200,000.00 €,
- "Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes (Faza II)" Komuna Shtime, Shuma e paguar nga MZHR - 140,000.00 €.

Veprimi - 3.3.2 - Ndarja e granteve për rritjen e kapaciteteve prodhuese të bizneseve në zonat ekonomike me theks të veçantë për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar;

MZHR ka ndërmarrë veprime konkrete përmes thirrjes publike, organizimit të 5 sesioneve informuese për promovim të formave të bashkëpunimit për zhvillimin socio-ekonomik. (MZHR).

Në vitin 2024, ka përzgjedhë 189 përfitues dhe janë implementuar 188 projekte nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar, në vlerë prej 1,715,737.00 €, prej të cilave 72 përfitues janë në fushën e prodhimit dhe 117 të shërbimit:

Fusha e prodhimit:

- Prodhim i artikujve prej letre dhe kartoni ku përfshin prodhimin e fletoreve, kopertinave, kuponave, librave të shitjes dhe të blerjes për biznese, libër protokoli;
- Prodhimi i Drurit-Zdrukthtari;
- Prodhimi i këpucave;
- Prodhimi Tekstilit-Rrobaqepes;
- Prodhimi metaleve-Kontruksione Metaike etj.

Fusha e shërbimit:

- Sherbime gjeodozike dhe kadastrale;
- Sherbime Kontabilitetit;
- Sherbime ushqimeve-pasticeri;
- Sherbime te reklamave,audios-Marketing;
- Riparim i automjeteve-Servis i automjeteve etj.

MZHR ka ndërmarrë veprime konkrete dhe ka publikuar thirjen e veçant për PZHRB për veprimtaritë e bizneseve mikro Zejtare/Manifakturë, Artizanale, Inovative!

Në vitin 2024, MZHR ka përzgjedhë 12 përfitues dhe janë implementuarv 8 nga to kurse 4 janë në fazen implementuese në vlerë prej 22,995.00 €,

**VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM LIDHUR ME TË ARRITURAT DHE REZULTATET
PËR IMPLEMENTIM TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIM RAJONAL PËR VITIN 2024**

Sfidat e implementimit gjatë vitit 2024 kanë qenë:

- Aprovimi i drafteve të 4 Rregulloreve të cilat derivojnë nga Ligji për Zhvillim Rajonal;
- Zbatimi i tri programeve zhvillimore të MZHR-së për vitin 2024 ku kërkohet edhe angazhim tjetër në kuadër të punëve dhe detyrave që dalin nga Divizionet përkatëse në kuadër të Departamentit për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal.
- Aprovimi i Rregullores (ZKM) Nr. 02/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë për Zhvillim Rajonal .
- DPAR/MZHR, koordinimi i aktiviteteve me akterët relevant dhe mbledhja e të dhënave.
- Numër i vogël i stafit.

Më poshtë gjeni tabelën ku është vendosur buxheti që është shpenzuar gjatë vitit 2024:

1. Programit për Zhvillim Rajonal i kapitaleve për Komuna) për periudhën 2024:

Përshkrimi	Nr i Aplikimeve	Buxheti ne dispozicion	Nr i Projekteve te financuara	Vlera totale e fiancimit
PZHR 2024	51	4,000,000.00	19 komuna 19 projekte	1,986,924.76

2. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (Përkrahja e bizneseve 2024:

Përshkrimi	Nr i Aplikimeve	Buxheti ne dispozicion	Nr i Projekteve te financuara	Vlera totale e fiancimit
PZHRB 2024	1424	2,000,000.00	189 projekte	1,715,737.00

3. PZHRB për veprimtaritë e bizneseve mikro Zejtare/Manifakturë, Artizanale, Inovative

Përshkrimi	Nr i Aplikimeve	Buxheti ne dispozicion	Nr i Projekteve te financuara	Vlera totale e fiancimit
PZHRB 2024	17	50,000.00	12 projekte	22,995.00 €

4. Programi me OSHC 2024

Përshkrimi	Nr i Aplikimeve	Buxheti ne dispozicion	Nr i Projekteve te financuara	Vlera totale e fiancimit
OSCH 2024	124	245,000.00	61 projekte	241,090.00